




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dop. Dop.	2-D/DPK
Nr. i tag Broj stranica Nr. pages	02
Nr Prot. Br Prot. Prot No	01-1946/2012
Data Datum Date	24.05.2012
PRISTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 04.05.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK– 03-5080/11, për Zyrtaren e Lartë, znj.Valdete Serreqi, u.d. e Drejtorit të Klinikës Psikiatrike në QKUK-Prishtinë, për shkak se Zyrtarja e Lartë ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK–03-5080/11, që për trajtim ka pasur Zyrtaren e Lartë, znj.Valdete Serreqi, u.d. e Drejtorit të Klinikës Psikiatrike në QKUK-Prishtinë

Pas zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtarja e lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik ka qenë duke ushtruar pozitë udhëheqëse si pronar dhe person i autorizuar në biznesin “O.P. Shëndeti ” në Viti, e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 27.03.2012, e ka njoftuar zyrtaren e Lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, znj.Valdete Serreqi, u.d.i Drejtorit të Klinikës Psikiatrike në QKUK-ë, Prishtinë, ka ardhur të ballafaqohet me faktet që posedon Agjencia, me datën 11.04.2012 gjatë takimit është biseduar për gjendjen dhe faktet që disponon Agjencia lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit.

Zyrtarja e lartë, Valdete Serreqi, u.d.e Drejtorit të Klinikës Psikiatrike në QKUK-ë, Prishtinë ,gjatë takimit është pajtuar për situatën mirëpo është arsyetuar se nuk ka qenë informuar për këtë, pasi që nuk e ka informuar askush që nga momenti i zgjedhjes si u.d. i Drejtorit dhe nuk ka pas njohuri për këtë situatë që mundë të shkaktoj konflikt të mundshëm të interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik.

Valdete Serreqi, u.d.e Drejtorit të Klinikës Psikiatrike në QKUK-ë-Prishtinë, është zotuar se në afatin ligjor do të ndërpres udhëheqjen e biznesit dhe do ta bëjë shmagjen konfliktit të mundshëm të interesit duke e autorizuar dikën tjetër që ta udhëheqë biznesin gjatë kohës sa ushtron funksionin Publik.

Me datën 25.04.2012, znj.Valdete Serreqi, u.d.e. Drejtorit të Klinikës Psikiatrike në QKUK-Prishtinë, ku dëshmohej znj.Valdete Serreqi nuk ka më pozitë udhëheqëse por ka autorizuar një person tjetër si person të autorizuar në Biznesin [“ O.P. Shëndeti”].

Në bazë të kësaj konstatojmë se Zyrtarja e Lartë, znj.Valdete Serreqi, u.d. e. Drejtorit të Klinikës Psikiatrike në QKUK-Prishtinë ka shmangur konfliktin e mundshëm të interesit.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtör i Agjencisë kundër Korrupsionit

